

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo  
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije  
Ministry of Finance  
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo

ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE

Njësia Org. Nr. Prot.  
Org. Jedinica Br. Prot.  
Org. Unit Prot. No. 09-06-2688

Nr. i faqeve Data  
Broj stranica Datum  
No. pages: 26, 06, 19

Hyrese PRISHTINE, A



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR / FOND ZA ZDRAVSTVENO OSIGURANJE  
HEALTH INSURANCE FUND

Njësia Org. Nr. Prot.  
Org. Jedinica Br. Prot.  
Org. Unit Prot. No. 1381

Nr. i faqeve Data  
Broj stranica Datum  
No. pages: -4- 26.06.19

PRISHTINË - PRISHTINA - PRISTINA

**Republika e Kosovës**

*Republika Kosovo – Republic of Kosovo*

Qeveria – Vlada – Government

## **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

në mes

**ADMINISTRATËS TATIMORE TE KOSOVËS**

dhe

**FONDIT PËR SIGURIME SHËNDETËSORE**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi e lidhur në mes palëve është e bazuar në Ligjin Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Ligjin Nr. 04/1 -249 për Sigurimin Shëndetësor, si dhe Ligjin Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## **1. QËLLIMI**

- 1.1 Qëllimi i kësaj Marrëveshje është sforcimi i bashkëpunimit ndërmjet Fondit për Sigurime Shëndetësore (FSSh) dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) në bazë vendosja e kornizës së bashkëpunimit për zbatimin e plotë të kësaj Marrëveshjeje.
- 1.2 FSSh dhe ATK (më tutje: palët) sigurojnë shkëmbim reciprok të të dhënave që palët i kanë në pronësi apo me të cilat disponojnë me qëllim që të bëhet identifikimi i personave fizikë dhe juridikë që janë pagues të tatimeve, si dhe unifikimin e të dhënave personale.

## **2. FUSHËVEPRIMI**

- 2.1 Fushëveprimi i kësaj Marrëveshjeje është dhënia e shënimeve nga Lista e pagave të deklaruara në ATK përmes Sistemit Elektronik EDI, konkretisht numrit personal identifikues të qytetarit të regjistruar në Regjistrin Civil të Kosovës, si dhe të dhënat e premiumeve shëndetësore.
- 2.2 Shkëmbimi i të dhënave do të bëhet në formë elektronike.

## **3. RËNDËSIA**

- 3.1 Shkëmbimi i shënimeve është i një rëndësie të madhe për qytetarin, i cili është i punësuar dhe përmes punëdhënësit atij i paguhen premiumet shëndetësore.
- 3.2 Informatat e deklaramit të punëdhënësit për të gjithë të punësuarit e tij do të jenë shumë të rëndësishme për palët për t'u krahasuar me të dhënat nga Banka Qendrore e Kosovës për pagesat e premiumeve shëndetësore.
- 3.3 Ofrimi i numrave personal të qytetarëve, vlerave të premiumeve nga punëmarrësi dhe punëdhënësi, për palët do të kenë rëndësi me qëllim të identifikimit të saktë të individëve që janë persona potencial për kërkimin e shërbimeve shëndetësore në Kosovë.

## **4. MËNYRA E SHKËMBIMIT TË INFORMATAVE**

- 4.1 Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet palëve të përcaktuar më këtë Marrëveshje bëhet në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit (PSV), të cila i janë bashkangjitur kësaj Marrëveshjeje dhe përbëhen pjesë integrale e saj.
- 4.2 PSV-të, do të parashohin të gjitha procedurat se si do të bëhet shkëmbimi në mes palëve, si dhe do të definojnë llojin e të dhënave të cilat do të shkëmbehen në nivel teknik të informatave.

## **5. ZOTIMET E FSSH-së**

- 5.1. FSSH do të sigurojë sistemet e Teknologjisë Informative të duhura për ndërveprim në mes të palëve
- 5.2. FSSH-ja zotohet të mbajë resurset në gjendje të qasshme dhe të përditësuar.
- 5.3. FSSH-ja zotohet që të dhënat të cilat do të shfrytëzohen nga zyrtarët e saj të i nënshtrohen mekanizimeve të sigurisë dhe si të tilla do të përdoren vetëm për qëllime të kësaj Marrëveshjeje dhe të njëjtat do të jenë të qasshme vetëm nga palët e autorizuara.

## **6. ZOTIMET E ATK--së**

- 6.1. ATK do të sigurojë sistemet e Teknologjisë Informative të duhura për ndërveprim në mes të palëve.
- 6.2. ATK -ja zotohet të mbajë resurset në gjendje të qasshme dhe të përditësuar.
- 6.3. ATK -ja pajtohet që të dhënat që janë në pronësi apo më të cilat disponon në lidhje me personat fizikë dhe juridikë si tatimpagues në Kosovë, të i vë në dispozicion të FSSH-së në kohë reale, përmes qasjes në bazat e saj të të dhënave.
- 6.4. ATK -ja zotohet të njoftojë pa vonesë FSSH-në në rast të ndryshimit të çfarëdo të dhëne të kërkuar si më lartë të secilit person fizik apo juridik si tatimpagues të Republikës së Kosovës.

## **7. RUAJTJA E INFORMATAVE TË MBLEDHURA DHE MBIKËQYRJA**

- 7.1. Palët pajtohen që të dhënat që do të shkëmbehen janë konfidenciale dhe si të tilla do të përdoren vetëm për qëllime të kësaj Marrëveshjeje dhe vetëm brenda kornizës së saj.
- 7.2. Përpunimi dhe përdorimi i të dhënave personale nga ky memorandum duhet të bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
- 7.3. Në rast të dyshimit për shkelje të sigurisë së informatave të çfarëdo forme, pala e dëmtuar duhet të njoftojë menjëherë palën tjetër dhe se të dy palët rezervojnë me këtë rast të drejtën për të ndërprerë përkohësisht shkëmbimin e të dhënave pas çdo informacioni të besueshëm apo kërcënimeve tjera që lidhen me sigurinë e Sistemit të Teknologjisë Informative të të dy institucioneve.

## **8. PËRGJEGJËSIA**

- 8.1. Secila Palë do të jetë përgjegjëse vetëm për mënyrën në të cilën ajo kryen pjesë të aktiviteteve të bashkëpunimit në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe / ose ndonjë marrëveshjeje tjetër. Kështu që, asnjëra palë nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë humbje, aksident, dëmtim që i është shkaktuar ose e ka shkaktuar pala tjetër, ose nga punonjësit, konsulentët ose nën-kontraktorët e palës tjetër, në lidhje me ose si rezultat i bashkëpunimit për realizimin e aktiviteteve sipas kësaj Marrëveshjeje.

## 9. AFATI, NDËRPRERJA, AMANDAMENTIMI

- 9.1 Kjo Marrëveshje mbetet e vlefshme për afat të pacaktuar.
- 9.2 Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje të ndërsjellë me shkrim të palëve. Palët mundën, me shkëmbim letrash, të ndryshojnë ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ose të hyjnë në aranzhime plotësuese të disenjuara për të përcaktuar më tej fushëveprimin e kësaj Marrëveshjeje.

## 10. ZBATIMI DHE HYRJA NË FUQI

- 10.1 Palët nënshkruese u pajtuan që kjo Marrëveshje të fillojë se zbatuari nga data e nënshkrimit.
- 10.2 Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, palët obligohen në zbatimin e plote të kësaj Marrëveshjeje.
- 10.3 Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi është e nënshkruar nga personat e autorizuar dhe është e hartuar në dy (2) kopje të njëjta, nga një (1) kopje për secilën nga palët nënshkruese.

Për: Fondin e Sigurimeve Shëndetësore

Fatmir Plaqiqi,

Drejtor



---

Për: Administratën Tatimore të Kosovës

Ilir Murtezaj,

Drejtor



---

Prishtinë,

26 qershor 2019